




Komuna e Gjakovës



OJQ "Shtëpia e Sigurt"

**Marrëveshje Mirëkuptimi
ndërmjet**

Komunës së Gjakovës,

dhe

Organizatës Jo-qeveritare "Shtëpia e Sigurt" në Gjakovë

**për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të strehimores për një periudhë fillestare prej tre
(3) vitesh: 2020 - 2022.**

**Neni 1
Qëllimi i Marrëveshjes**

- 1.1 Kjo marrëveshje do të sigurojë mbështetje financiare të pjesshme, e caktuar në bazë të këtij dokumenti për nevojat e strehimores për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës mbi bazën gjinore si dhe viktimat e trafikimit me njerëz, për periudhën trevjeçare 2020 - 2022.
- 1.2 Strehimorja gjendet në Komunën e Gjakovës dhe u shërben viktimave të dhunës në familje, si dhe viktimave të trafikimit me qenie njerëzore nga komuna e Gjakovës, e cila është palë nënshkruese e kësaj marrëveshjeje.
- 1.3 Në rast se ndonjëra nga palët nënshkruese nuk dorëzon një njoftim tjetër deri në datën e përfundimit të kësaj marrëveshjeje, kjo marrëveshje do të ripërtërihet automatikisht për të njëjtën kohëzgjatje dhe me të njëjtat kritere, duke filluar nga data 1 janar 2023.

Neni 2

- 2.1 Komuna do të kontribuoj për nevojat financiare të strehimores siç është shprehur në përmbajtjen dhe frymën e këtij dokumenti.
- 2.2 Shkalla e kontributit vjetor që duhet të paguajë komuna për strehimoren llogaritet në përpjesëtim të drejtë me popullsinë që banon në Komunë. Gjatë periudhës tre-vjeçare 2020-2.3. Komuna mund të rrit vullnetarisht kontributin financiare, mirëpo jo edhe ta ulë shumën për të cilën është pajtuar. (shih nenin 3.1).

Neni 3

Detyrimet financiare

- 3.1 Shuma vjetore e kontributit të Komunës së Gjakovës drejt financimit të përgjithshëm vjetor të strehimores për periudhën trevjeçare 2020-2022, në përputhje me numrin e popullsisë, është € 4,000
- 3.2 Komuna do të sigurojë pjesën e caktuar të kontributit të vet financiar (shih 3.1) për secilin vit fiskal përkatës, përmes një kësti të vetëm që do të paguhet në xhirollogarinë e Strehimores, para datës 31 janar të secilit vit fiskal. Kjo formë e pagesës do të jetë e vlefshme për tërë kohëzgjatjen e këtij memorandumi, përgjatë viteve 2020, 2021, 2022 si dhe më pas, në rast se ripërtërihet.
- 3.3 Format e pagesës mund të rishqyrtohen dhe të vendoset nga Komuna tre muaj para përfundimit të kësaj marrëveshjeje, përmes një marrëveshjeje të veçantë e cila do të bëhet pjesë përbërëse e këtij marrëveshjeje.

Neni 4

Dispozitat përfundimtare

- 4.1 Strehimorja merr përsipër përgjegjësinë të ia sigurojë Komunës planin financiar/të shpenzimeve para datës 20 janar të secilit vit fiskal. Strehimorja do t'ia dorëzojë komunës llogaritë dhe raportet financiare që përmbajnë hollësitë e shpenzimeve të tyre tremujore duke filluar nga data 1 janar të secilit vit fiskal. Para datës 31 dhjetor të secilit vit fiskal, Strehimorja do t'i paraqesë komunës raportin përfundimtar financiar, i cili konsiderohet si parakusht për shpërndarjen e kontributit financiar për vitin e ardhshëm. Format e lartpërmendura të raportimit do të vazhdojnë deri në përfundimin e marrëveshjes, si dhe më pas, në rast se ripërtërihet.
- 4.2 Në rast se strehimorja nuk raporton për shpenzimet e veta siç kërkohet në nenin 4.1 të kësaj marrëveshjeje, Komuna mund të ndalojë pagesën përkatëse deri në momentin kur informacioni i kërkuar të jetë siguruar plotësisht.
- 4.3 Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.

4.4 Kryetari i komunës dhe drejtori i strehimores ka për detyrë të sigurojë zbatimin e plotë të pjesëve përkatëse të dispozitave të dakorduara në kuadër të këtij memorandumi.

Neni 5


Mosmarrëveshjet

5.1 Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve do të zgjidhen sipas vullnetit të mirë të palëve.

Gjakovë, 30.06. 2020


Palët nënshkruese:

Për Komunën e Gjakovës


Ardian Gjini, Kryetar



Për Strehimorën


Erblina Dinarama, Drejtoreshë

